VENDIM
Nr. 136, datë 15.8.2016

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "KESH" SHA PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË ERE-s NR. 111, DATË 1.7.2016 "MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMEVE NR. 139, NR. 141, NR. 145, NR. 146, NR. 147, NR. 148, DATË 26.12.2014, TË BORDIT TË ERE-s, PËR PERIUDHËN 1 KORRIK 2016 – 31 DHJETOR 2016

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe nenit 16 të Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.8.2016, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve, në lidhje me kërkesën e shoqërisë "KESH" sh.a., për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 111, datë 1.7.2016, "Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26/12.2014, të Bordit të ERE-s, për periudhën 1 korrik 2016 – 31 dhjetor 2016,

konstatoi se:

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar bashkëngjitur ankimimit, nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë provë e re që të çojë Bordin e ERE-s në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga vendimi nr. 111, datë 1.7.2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë "KESH" sh.a., për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 111, datë 1.7.2016, "Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, të Bordit të ERE-s, për periudhën 1 korrik 2016 – 31 dhjetor 2016.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë KESH sh.a., për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti